



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr. 10/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN, sipas gjyqtarit individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e praktikantes Tringa Jashari, në çështjen juridiko-civile të paditëses R.D.nga fsh. Sh...K. L..., të cilën me autorizim e përfaqson Veton Uka av. nga Vushtrria, me autorizim, ndaj të paditues Komunës së Lipjanit – Drejtoratit Komunal të Arsimit, të cilën e përfaqëson Behar Krasniqi, me autorizim, përshkak të kompenzimit të t’ardhurave personale, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.18.01.2023, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e precizuar e paditëses R. D. nga fsh. Sh... K. L..., si e **BAZUAR**, si dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit - Drejtorati i Arsimit në Lipjan, që paditëses t’ia paguajë shujtën ditore për periudhën 18.04.2017 e deri me dt.20.11.2022 për gjithësejt 920 ditë pune shumë prej 1,840.-€, këto me kamatë ligjore prej 8% nga data e ushtrimit të padisë 06.01.2020 e deri te pagesa definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 363.00.-€, e të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkespadiës së precizuar e paditësit sa i përket pagës jubilarë në shumë prej 75 % të një page bazë në lartësinë prej 315.75.-€.

A r s y e t i m

Paditësja R. Dr. nga fsh. Sh... K. L..., në këtë gjykatë përmes të autorizuarit ka ushtruar padi ndaj të paditues Komunës së Lipjanit, për shkak të kompenzimit të pagave jubilarë dhe shujtjes ditore për ditët e pranisë në punë.

Në padi dhe në shqyrtimin gjyqësor i autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësja është në marrdhënie pune si mësuese klase në shkollën fillore “I. B.” në fsh. Sh... dhe ka kërkuar kompensimin e pagës jubilarë 75 % të pagës bazë në lartësi prej 315.75.-€ duke theksuar se paditësja ka përvojë pune prej 28 vite dhe i takon shpërblimi jubilar. Gjithashtu ka kërkuar kompensimin e shujtës ditore në vlerën prej 2.-€ në ditë aq sa është paraparë në Kontratën Kolektive, për periudhën 18.04.2017 e deri me dt.20.11.2022, pra për gjithësejt 920 ditë pune në lartësi prej 1,840.-€ të gjitha këto me kamatë ligjore.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbetet edhe më tutje pranë padisë, dhe precizimit të bërë, duke shtuar se baza juridike e padisë mbështet në Kontrat Kolektive që kanë qenë në fuqi për periudhën kontestuese andaj ka propozuar që kërkesat të aprovohen si të bazuara pasi që kanë mbështetje në nenin 35 par.7 të Kontratave Kolektive ndërsa shpërblimi jubilar prej 75 % të pagës bazë poashtu është vërtetuar në bazë të listës së pagës andaj ka kërkuar që të aprovohet kërkespadia e precizuar si e bazuar.

Shpenzimet e procedures i ka kërkuar sipas TOAK-së, te specifikuara në fjalën përfundimtare.

Në të përgjegjur në padi në formë te shkruar, e paditura e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e pales paditëse me arsyetimin se çështjet e kërkuara në padi janë pa bazë ligjore dhe se paditësi është punësuar tek e paditura dhe askund në kontratën e punës nuk ceket se punëtori i gëzon këto të drejta dhe paditësja i ka nënshkruar këto kontrata dhe është pajtuar me kushtet e kontratës si dhe detyrimet që i përmban. Poashtu as me Ligjin e Punës i cili rregullon kontestet e punës nuk ceket askund se punëtorëve iu takon kompensime të tilla, andaj kërkesës së paditësit i mungon baza juridike. Poashtu ka shtuar se Kontrata Kolektive është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi që e rregullojnë marrdhënien e punës e poashtu Komuna e Lipjanit nuk është nënshkruese e kësaj Kontrate Kolektive dhe kjo është e lidhur në mes MASHT-së dhe SBASHKU-ut, andaj Ministria e Arsimit nuk e ka bërë harmonizimin me Ministrinë e Financave që të paditurën ta lejon ngritjen e tavanit të pagave në mënyrë që të ketë mundësi të bëhen pagesat shtesë për stafin arsimor, andaj ka propozuar që Gjykata ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Në fjalën përfundimtarë përfaqësuesi i të paditurës ka deklaruar se mbetet pranë kundërshtimeve duke I propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj sit ë pabazuar, duke u mbështetur në nenin 46 par.2 të Kontratës Kolektive.

Shpenzimet e procedures nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore gjykata në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave me shiqimin dhe leximin i kontratës së punës nr.04-112-813/357 të dt.01.09.2015, me shiqimin dhe leximin e vëretimit të përvojës së punës lëshuar nga shkolla “I. B.” në Sh..., nr.3/784 e dt.13.12.2022, me shiqimin dhe leximin e vërtetimit të ditëve të punës nr.3/785 i dt.13.12.2022 si dhe lista e pagës për paditësen, e të cilat prova gjykata i administroj dhe i vlerësoj në pajtim me nenin 8 të LPK-së, ku vërtetoi këtë gjendje faktike:

a). Se paditësja R. Dr. nga fsh. Sh...ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura ne shkollën SHFMU “I.B.” në Sh..., si mësuese klase, ku e njëjta ka gjithësejt 28 vite e 10 muaj përvojë pune.

b) Se nga periudha 18.04.2017 e deri me dt.20.11.2022 e njëjta ka gjithësejt 920 ditë pune andaj shujta ditore u caktua në bazë të ditëve të punës të realizuara të shumëzuara me 2.-€ në ditë apo shumën e përgjithshme prej 1,840.00-€.

Faktin nën a) gjykata e vërtetoi nga kontrata e punës nr. 04-112-813/357 e dt.01.09.2015, e lidhur në mes paditëses R. D. dhe të paditures.

Faktet nën b), gjykata i vërtetoi nga e vërtetimit i ditëve të punës nr.3/785 i dt.13.12.2022.

Me paragrafin 7 të nenit 35 te Kontratave Kolektive parashifet se “ Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë dhe ate 2.-€ në ditë.

Poashtu e drejta e pages jubilarë është e paraparë edhe me nenin 35 par.8 të Kontratës Kolektive.

Me dispozitat e nenit 8 të LMD-së, të R. së Kosovës, parashihet se “Pjesmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Ndërsa me dispoziten e nenit 245 po të njejtit Ligj parashihet se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegjëje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Pra, bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe dispozitat e lartëcekura gjykata vjen në përfundim se paditësja ka punuar tek e paditur si mesuese klase në shkollën fillore “I. B.”

në fsh. Sh..., ku e njëjta gjatë periudhës 18.04.2017 e deri me dt.20.11.2022 paditësja ka punuar gjithësejt 920 ditë pune dhe për këto ditë dhe bazuar në Kontratën Kolektive iu është gjykuar shujtja ditore duke iu llogaritur nga 2.-€ per ditet e punës gjithësejt në lartësi prej 1,840.-€, për çka edhe u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pikës II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata kërkesën lidhur me pagesën jubilarë për 20 vite të përvojës së punës prej 75 % të një page bazë në lartësi prej 315.75.-€, e refuzoi si të pabazuar, me arsyetimin se sipas nenit 35 par.8 të Kontratës Kolektive të dt.22.01.2021 por edhe të Kontratës Kolektive të mëparshme (18.04.2017) të nenit 35 par.8, parashihet se shpërbilimi jubilar paguhet nga punëdhënsi kur i punësuari i ka plotësuar kushtet dhe kjo paguhet me rastin e 7 Marsit të cdo viti, çka domthenë se obligimi i punëdhënësit për pagesë të shpërbilimit jubilar arrin për detyrim kur i punësuari e arrin vitin jubilar dhe ky detyrim duhet të përmbushet me 7 Mars të çdo viti dhe në rastin konkret paditësja i ka 28 vite e 10 muaj përvojë pune dhe nuk ka vitë jubilar për ta realizuar shpërbilin jubilar andaj nga këto arsye vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoj kundërshtimet e të paditues mirëpo të njëjtat kundërshtime i refuzoj si të pabazuara me arsyetimin se Kontratën kolektive të Arsimit kanë qenë në fuqi për kohën sa ka kërkuar paditësja përmbushjen e kërkesës dhe e detyrojnë punëdhënësin e fundit për pagesë dhe e paditura duhet dhe ka për detyrim t'i përmbahet të njëjtave nga se të njëjtat janë në pajtim me Ligjin e Punës dhe po ashtu me nenin 46 të Kontratës Kolektive të dt.18.04.2017 dhe nenit 45 të Kontratës Kolektive të dt.22.01.2021 është paraparë që MASHT-i dhe SBASHK-u angazhohen për t'i informuar Komunitet qe me kohë të bëjnë planifikimin e buxhetit për zbatimin e këtyre të drejtave dhe po ashtu të angazhohen në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunitet me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Vedimi për kamaten ligjore u bazua në nenin 382 të LMD-së.

Meqenëse palet paditëse e ka fituar kontestin dhe i ka kërkuar shpenzimet gjykata në pajtim me nenin 452 dhe 453 të LPK-së, e detyroj të paditues që paditëses t'ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: për përpilimin e padisë, në shumë prej 104.00 €, për pecizimin e padisë shumë prej 104.00.-€, për 1 seancë gjyqësore të përfaqësuar nga i autorizuari i pales paditëse në shumë prej 135.00.-€, si dhe në emër të taksës për padi në shumë prej 20.-€, apo shumë prej 363.00.-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti për çka është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të dispozitivave të lartëcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN.

C. nr. 10/2020 me dt. 18.01.2023

**GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate.